



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:017933

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05643456

C-IV.-13-1450

Ankuesi:

N S I nga Vushtrria.

Kundër

Pala kundërshtare:

N.SH “METAMB”, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rruga “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Dr.sc. Murat Hulaj, me dt.30 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e ankuesit dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr.PRN049-0047 të dt.16 korrik 2013.
- Në këtë çështje nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me dt.05 gusht 2013, ankuesja kishte paraqitur kërkesë për rishikim të vendimit në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit nr. PRN049-0047 të dt.16 korrik 2013, me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensimin pagave të pa paguara për periudhën kohore nga viti 1990 deri në vitin 1999 nga N.SH “Metamb” (në likuidim). Ankuesja në ankesë ka pohuar se ankesën e paraqet për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ka shuar se AL ia ka refuzuar kërkesën me arsyetimin se e njëjta është parashkruar dhe se aplikimi i nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar është i në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë. Ankuesja së bashku me ankesë ka bërë dorëzimin e kopjes së vendimit të kundërshtuar, Aktvendim mbi pushimin e shtatzënisë, Çregjistrim i sigurimit,

Aktvendim për përcaktimin e shumës së pikëve në punët dhe detyrat punuese nr.01-22.-dt.30.07.1990, Aktvendim nr.934 dt.05.06.1991, Aktvendimi nr.1035.

E paditura me dt.20 shtator 2018, e ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se i përmbahet qëndrimit se AL ja bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. Objekti i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit. Vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore dhe nuk ka bazë ligjore për ta shfuqizuar të njëjtin. Ka shtuar se kërkesa do të duhej të ishte paraqitur në ndonjë gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda tri viteve, nga momenti kur NSH-ja pretendohet të mos i ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtrueses. Ka kërkuar që ankesa e ankueses të refuzohet si të pa pranueshme dhe të pa bazuar.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj lënde me dt.04 prill 2024, ka lëshuar një urdhër për ankuesen përmes të cilit ka kërkuar nga e njëjta që të bëjë dorëzimin e librezës së punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës në emrin e ankueses, listën e pagave të cilat ankuesja nuk i ka pranuar si dhe prova tjera me të cilat i mbështet pretendimet ankimore. Ankuesja e ka pranuar të njëjtin dhe me dt. 15 prill 2024, i është drejtuar gjykatës me parashtrësë duke bërë dorëzimin e provave të njëjta të cilat ia ka bashkangjitur ankesës bazë.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar dhe Vërtetohet vendimi i AL-së.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa par.3 parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e tilla dështojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesja ka qenë punëtore e NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmojë se i takon kompensimi për paga të pa paguara për periudhën kohore 1990 -1999. Ankuesja së bashku me ankesë ka bërë dorëzimin e kopjes së vendimit të kundërshtuar, Aktvendim mbi pushimin e shtatzënisë-lehonisë, Çregjistrim i sigurimit, Aktvendim për përcaktimin e shumës së pikëve në punët dhe detyrat punuese nr.01-22.- dt.30.07.1990, Aktvendim nr.934 dt.05.06.1991, Aktvendimi nr.1035. Pra, ankuesja nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme lidhur me të cilat do të bënte të besueshme se të njëjtës i takon kompensimi për paga të pa paguara për periudhën e kërkuar, ashtu që ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së saj në tërësi.

Vendimi i Autoritetit të Likuidimit si dhe provat tjera të dorëzuara nga ankuesja së bashku me ankesë si dhe përmes parashtresës nuk mund të shërbejnë si prova të vetme për ti njohur të drejtën e pretenduar në ankesë. Andaj këto prova nuk vërtetuan në tërësi kërkesën e saj. Provat të cilat i ka dorëzuar dorëzoi nuk e vërtetojnë se të njëjtës NSH i ka mbetur borxh paga të pa paguara për periudhën 1990 – 1999. Pra, gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankueses lidhur me të drejtën e saj të pretenduar, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla ankesa e ankueses është refuzuar si e pabazuar.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par..4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore:

Duke u bazuar në nenin 62 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtari,
Dr.sc.Murat Hulaj